



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Nr. i Protokollit: 14-111/01-0005244/25

Datë: 13.01.2025

Në bazë të Nenit 80 dhe 81 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtar Publik të Republikës së Kosovës, Neni 5 Paragrafi 1, Neni 7, Neni 9, Neni 10, Neni 11 dhe Neni 12 të Udhëzimit Administrativ Mfpt-Nr. 01 /2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik Komuna e Prishtinës, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK

DREJTORIA E KULTURËS

I. POZITA: Skenograf në Teatrin e Qytetit të Prishtinës “ Dodona “ – një (1) Ekzekutues

KOEFICIENTI : 7.5

KLASA : K7

LLOJI I POZITËS: I karrierës

ORARI I PUNËS: 40 orë në javë

PËRGJEGJËSIA MBIKËQYRËSE : Jo

MBIKËQYRJA: Drejtori i Teatrit të Qytetit të Prishtinës DODONA

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :

- Ideon dhe përgatit skenografinë për Shfaqjet Teatrale si dhe ngjarjet tjera të ngjajshme teatrale;
- Ndhmon Drejtorin dhe Trupën Artistike në planifikimin e shfaqjeve dhe ngjarjeve tjera kulturore në teatër;
- Ndhmon Drejtorin dhe stafin tjetër të teatrit në planifikime financiare mbi materialet e nevojshme për skena
- Përcjellë punën e Mjshtrit të Skenografisë dhe Punëtorëve të Skenës për shfaqjet e planifikuara në repertoar
- Evidenton rekuizitat e nevojshme për shfaqjet teatrale
- Asiston regjisorët në prova dhe përgatitje teknike të shfaqjeve;
- Kryen të gjitha detyrat e tjera që i ngarkon Legjislacioni në Fuqi.

Faqe 1 nga 6

Kushtet:

- Të ketë përgatitje shkollore universitare nga fusha përkatëse e kulturës, Diplomë Universitare: Fakulteti i Arteve-Drejtimi Skenografi;
- Të ketë përvojë pune profesionale në fushën përkatëse të institucionit të kulturës ku aplikon,;
- Të ketë njohuri të përgjithshme mbi artin dhe kulturën, veçanërisht në fushën përkatëse;
- Shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktimit të objektivave dhe planifikim;
- Njohja e programeve kompjuterike për realizimin e projekteve është e domosdoshme
- 1 vit përvojë profesionale.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Qendrën për Shërbim me Qytetarë të Komunës së Prishtinës, Kati Përdhësë në Ndërtesën e Komunës së Prishtinës, si dhe mund të shkarkohet nga ueb faqja zyrtare e Komunës së Prishtinës, dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në Qendrën për Shërbim me Qytetarë të Komunës së Prishtinës apo të dërgohen me postë në këtë adresë: Komuna e Prishtinës, Rruga UÇK Nr. 2, Prishtinë, Sejtori i Burimeve Njerëzore, Kati II, Zyra Numër 229.

Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- a) Formulari i Aplikimit i Plotësuar;
- b) Kopje e Diplomës së Fakultetit;
- c) Kopjet e dokumentacionit të përvojës së punës;
- d) Kopjet e dokumentit personal;
- e) Dëshmi mjeksore se kandidati është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse (prezantohet nëse kandidati përzgjidhet për emërim);
- f) Dokumenti që nuk jeni dënuar ve vendim të formës së prerë nga gjykata (lëshuar nga Gjykata Themelore);
- g) Nëse këzhgjatja lidhur me përvojën e kërkuar të punës është në Sektorin Publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati me të cilën dëshmohet se ai/ajo nuk ka masë disiplinore në fuqi për shkelje të rëndë të pushuar sipas Ligjit për Zyrtarët Publik;
- h) Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore (personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit);
- i) Kopjet e dëshmive të trajnimeve.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- a) Testimi me shkrim;
- b) Intervistë

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët, si dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:

Përmes uebfaqes së Komunës së Prishtinës (<https://kk.rks-gov.net/prishtine/>) si dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net/>).



Afati i aplikimit është 30 ditë nga dita e publikimit në Sistemin Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Kandidatët e interesuar mund t'i marrin aplikacionet nga data 13.01.2025 në Qendrën për Shërbim me Qytetarë të Komunës së Prishtinës, aplikacionet e plotësuara së bashku me dokumentet e kërkuara sipas kriterëve të këtij konkursi mund t'i dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë të Komunës së Prishtinës deri më 12.02.2025.

VËREJTJE: Fletë aplikacionet e kandidatëve me dokumente të pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit, nuk do të merren në shqyrtim, dhe dokumentacioni nuk do të kthehet.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT-i, apo vërtetimin që kanë aplikuar për nostrifikimin e diplomës së tyre/

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Burimeve Njerëzore në nr. tel: 038/230-900, lok. 10-70, prej orës 08:00 – 16:00 me adresë Komuna e Prishtinës, Rruga UÇK nr. 2, Prishtinë – Republika e Kosovës.